



DETYRË PROJEKTIMI

Per projektin:

“Rikonstruksioni i Godinës së Korpusit Qëndror në SUT”

01

HYRJE – INFORMACION I PËRGJITHSHËM

1.1. Emërtimi i Projektit

“Rikonstruksioni i Godinës së Korpusit Qëndror në SUT”

1.2. Vendndodhja

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

1.3. Autoriteti Kontraktor

Spitali Universitar i Traumës

02

OBJEKTIVI, QËLLIMI DHE REZULTATET QË PRITEN

2.1. Objektivi



Objektivi i kësaj “Detyre Projektimi” është vlerësimi Tekniko- Ekonomik i të gjitha ndërtesave që ndodhen brenda Korpusit Qëndror të Spitalit Universitar të Traumës dhe evidentimi i ndërhyrjeve të nevojshme për krijimin e ambienteve me standarte bashkëkohore shërbimi dhe në përputhje me nevojat e pacientëve.

2.2. Qëllimi

Qëllimi kryesor i projektit të sipërpërmendur është rikonstruksioni total i të gjithë elementeve të objektit, duke nisur nga rikonstruksioni dhe rifiniturat e godinave, duke përfshirë rehabilitimin e sistemit konstruktiv (nëse paraqitet problematike), çmontimit dhe largimit të të gjithë instalimeve të sistemeve të ndryshme (elektrik, të kondicionimit, aspirimit, të kamerave, etj), brenda hapësirës së Korpusit Qëndror të Spitalit Universitar të Traumës.

Grupi i Projektimit duhet të marrë parasysh të hartojë dhe të projektojë të gjitha sistemet e nevojshme teknike, teknologjike dhe sistemeve mbrojtëse sipas standarteve për vënien në punë dhe funksionimin normal të objekteve me funksione të tilla. Korpusi Qendror ka nje siperfaqe totale prej 35 280 m² nga ku Sipefaqja totale e Godinave dhe ambienteve te brendshme eshte 10 535 m². Siperfaqet e gjelberta (lulishte) zene hapsiren prej 8545 m² dhe rruget e brendshme se bashku me sheshet e parkimit te automjeteve zene hapsiren prej 16 200 m².

Në Korpusin Kryesor përfshihen këto godina dhe Pavione të cilat kanë nevojë për ndërhyrje si më poshtë :

Blloku 1 (trekatëshe)

- 1- Ortopedi I
- 2- Ortopedi II dhe III
- 3- Kirurgji I

Blloku 2 (trekatëshe)

- 4- Kirurgji II
- 5- Reanimacioni

Blloku 3 (dykatëshe + 1 kat nëntokë)

- 6- Urgjenca dhe Sallat e Urgjences (kati I përdhe)
- 7- Blloku Operator (kati I parë)
- 8- Imazheria (kati nëntokë)

Blloku 4 (njekatëshe, një pjesë dykatëshe)

- 9- Rezonanca, Skaneri (dy kate, kati përdhe dhe kati I parë)
- 10- Magazina, mensa (kati përdhe)
- 11- Salla e telemedicines (kati përdhe)
- 12- Salla e Leksioneve të Ortopedisë (kati nëntoke)



Bloku 5 (dykatëshe)

13- Neurokirurgjia (kati I parë)

14- ORL Okulistike dhe Kirurgji Maksilofaciale (kati I parë)

Arkitektura dhe sistemet bashkëkohore do të gjejnë zgjidhjen më të mirë të mundëshme.

Nëpërmjet këtij projekti synohet:

- Të përmirësohen ndjeshëm kushtet e shërbimit në ambjentet e Godinave të Spitalit Universitar të Traumës.
- Të rinovojë të gjitha sistemet teknike të godinës si instalimet elektrike, instalimet hidraulike, instalimet e gazit medical, HVAC, MNZ, etj sipas standarteve europiane për ti kthyer ato në objekte bashkëkohore dhe të denja për funksionin që kanë.
- Në realizimin e projekteve të mirëfillta arkitektonike duhen patur parasysh dhe të gjejnë zbatimin e duhur të gjitha rregullat dhe normat urbanistike dhe arkitektonike për personat me aftësi të kufizuar PAK. Sipas VKM Nr. 1503, Datë 119.11.2008 “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”
- Godinat dhe pavionet janë godina të vjetëra, te amortizuara dhe kërkojnë ndërhyrje të specializuara.
- Të gjitha funksionet që kryhen në këto godina do të mbulohen përsëri në të njëjtën gjurmë.

a. Kërkesat e Projektit

“Grupit të Projektimit” i kërkohet të analizojë gjendjen ekzistuese të objekteve dhe ambienteve të jashtme brenda territorit të Korpusit Qëndror dhe të propozojë një projekt i cili të jetë i denjë për rëndësinë dhe funksionin që kanë objektet brenda Korpusit.

Rikonstruksioni i godinave duhet të konceptohet në mënyrë që të plotësojnë kërkesat e mëposhtme pa e prishur organizimin aktual dhe funksional të ambienteve.

b. Standardet

Për projektin e rikonstruksionit të këtyre objekteve “Grupi i Projektimit” duhet të përdorin standardet më të mira dhe të përshtatëshme për këto tipe objektesh. Gjatë projektimit, “Grupi i Projektimit” do të duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë me autoritetin me qëllim përmbushjen e kërkesave dhe nevojave të tyre.

2.3. Realizimi i Projektit

Asistenca teknike dhe profesionale që do të ofrohet në bazë të kësaj kontrate shërbimi do të



kontribuojë në realizimin e projektit të detajuar të këtij objekti.

“Grupi i Projektimit” do të duhet të hartojë “Projektin e Zbatimit”, i cili duhet të përfshijë:

- Projektet Arkitektonike.
- Projektet Konstruktive (*nëse do të ketë ndërhyrje konstruktive*).
- Projektet Elektrike.
- Projektet Hidroteknike (*furnizim me ujë*).
- Projekti KUZ
- Projektet e Mbrojtjes nga Zjarri (*MNZ*).
- Projektet e Ngrohje-Ventilimit.
- Projektet e Sistemit të Gazit Medikal.
- Projektet e Instalimeve Data, të Telefonisë dhe TV, Sistemi i Kamerave.
- Projekti I Sistemit të Ambienteve të Jashtme (*Rruge të brendshme, Sheshe parkimi, lulishte etj*)
- Relacioni teknik për çdo pjesë të projektit.
- Specifikimet Teknike (*të përfshihen të gjitha pajisjet që do instalohen*).
- Preventivin me dhe pa çmime për çdo ndërhyrje ndërtimore.
- Grafikon e Realizimit të Punimeve.

Projektet arkitektonik (formati A3) duhet të përfshijnë këto fletë:

- Planvendosje e përgjithshme e objekteve;
- Planvendosje me orthofoto e objekteve;
- Planimetritë e gjëndjeve ekzistuese
- Planimetritë e pas rikonstruksionit (dimensionimi);
- Planet e mobilimit
- Planet e evidentimit të dyerve;
- Planet e evidentimit të dritareve;

Projektet konstruktive (formati A3) duhet të përfshijnë këto fletë:

Në vartësi të nivelit dhe llojit të ndërhyrjes, nëse do të ketë ndërhyrje konstruktive, aty ku është e nevojshme (perforcime, ndryshime konstruktive në interier) duhen:

- Planet;
- Detaje konstruktive

Projektet elektrike (formati A3) duhet të përfshijnë këto fletë:



- Planet e instalimeve elektrike të ndriçimit;
- Planet e instalimeve elektrike të ndriçimit te emergjencës;
- Planet e instalimeve elektrike të prizave;
- Planet e skemës elektrike të shpërndarjes së fuqisë;
- Planet e mbrojtjes atmosferike;

Projektet Hidroteknike (furnizim me ujë dhe shkarkime) (formati A3) duhet të përfshijnë këto fletë:

- Planet e gjëndjes ekzistuese të nyjeve hidrosanitare;
- Planet e riorganizimit të nyjeve hidrosanitare;
- Planet e Sistemit të furnizimit me ujë;
- Planet e Sistemit të shkarkimit të ujërave të ndotura;
- Planet e Sistemit të ujrave të shiut;

Projekti KUZ (formati A3) duhet të përfshijnë këto fletë:

- Planimetria e KUZ
- Planpiketimi I KUZ
- Profili Gjatesor KUZ
- Profilet Terthore
- Plani I pusetave dhe Detaje te Pusetave te shkarkimit
- Armimi I Pusetave

Projektet e Mbrojtjes nga Zjarri (MNZ) (formati A3) duhet të përfshijnë këto fletë:

- Planet e Instalimeve të sistemit të sinjalizimit MNZ
- Planet e Instalimeve të mbrojtjes nga zjarri;
- Planet e Evakuimit;

Projektet e Ngrohje-Ventilimit (formati A3) duhet të përfshijnë këto fletë:

- Planet e Instalimeve të sistemit HVAC;
- Planet e Instalimeve elektrike të prizave/HVAC;
- Planet e Sistemit të kondicionimit VRF;
- Planet e Sistemit të kondicionimit VRF/pajisjet;
- Planet e Sistemit të Ventilimit;



- Planet e Sistemit të Ventilimit/pajisjet;
- Planet e Sistemit të Ventilimit/kanalet e ajrit;
- Planet e Sistemit të Ventilimit/grilat;

Projektet e Sistemit të Gazit Medikal (formati A3) duhet të përfshijnë këto fletë:

- Planet e Instalimeve të Sistemit të Gazit Medikal;
- Planet e Instalimeve të sistemit të shpërndarjes së oksigjenit;
- Planet e Instalimeve të sistemit të shpërndarjes së Ajrit Medikal
- Planet e Instalimeve të sistemit të shpërndarjes së Vakumit.

Projektet e Instalimeve Data, të Telefonisë dhe TV, Sistemi i Kamerave (formati A3) duhet të përfshijnë këto fletë:

- Planet e instalimeve të rrjetit kompjuterik DATA/Telefoni;
- Planet e instalimeve të rrjetit CCTV;
- Instalimet e sistemit të sigurisë;
- Instalimet e sistemit të kontrollit dhe monitorimit (sistemet mekanike dhe elektrike);

Projekti I Sistemit të Ambienteve të Jashtme (formati A3) duhet të përfshijnë këto fletë:

- Planin e përgjithshëm të Ambienteve të Jashtme.
- Planimetria e rrugëve të brendshme.
- Planimetria e shesheve të parkimit.
- Planimetria e pistes së helikopterit.
- Sinjalistika Rrugore (Vertikale dhe Horizontale).
- Rivitalizimi i sipërfaqeve me gjelberim.

Relacioni teknik (formati A4), i cili duhet të përmbajë:

- Relacioni total (arkitektonik, konstruktiv, elektrik, hidroteknik, MNZ, HVAC, data/telefoni);
- Përshkrimin e konceptit të projektimit, parametrat e projektimit, standardet e përdorura, llogaritjet e kryera;
- Ndërhyrjet konstruktive, nëse janë të nevojshme
- Dimensionimi i rrjetit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për çdo objekt



- Llogaritjet dhe skemat e paneleve elektrike;
- Llogaritje të ndryshme për shtimin e fuqisë;

Specifikime Teknike (formati A4):

“Grupi i Projektimit” duhet të përgatisë specifikimet teknike për të gjitha materialet që do të përdoren për realizimin e rikonstruksionit të godinave të.

Preventivi i projektit të zbatimit (formati A4 – në excel)

- Preventivin e zbatimit të punimeve të hartuar sipas manualit të çmimeve bazuar në VKM.Nr.629 datë 15/07/2015 si dhe bazuar në VKM nr.2, datë 8.5.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos në punimet e ndërtimit”);
- Analizën teknike të çmimeve për të gjitha zërat në preventiv bazuar në Manualin Teknik të miratuar me Vendim të KM 629, Tiranë – 15.07.2015.

Grafiku i punimeve (formati A3 – në excel)

Pjesë e projektit do të jetë edhe “Grafiku i Realizimit” të punimeve në format A3.

03

QËLLIMI I PROJEKTIMIT (BLOKU I)

Të përgjithshme - Përshkrimi i objekteve ekzistuese

Bloku 1 (trekatëshe)

- 1.Ortopedi I
- 2.Ortopedi II dhe III
- 3.Kirurgji I

Korpusi Qëndror i “Spitalit Universitar të Traumës”, të ndodhur në Rrugën “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë, ka filluar të shfrytëzohet në vitet 1930. Aktualisht ambientet shfrytëzohen dhe janë në funksionim normal për pacientët si dhe për personelin e shërbimit.

Gjendja e përgjithshme e objekteve, shfaqet e rënduar dhe e amortizuar në kohë. Në muret perimetrale, xokolaturat e betonit deri tek brezat ku fillojnë muraturat, kanë prezencë të vazhdueshme të lagështisë në to.

3.1. Kërkesa të përgjithshme

Projekti i rikonstruksionit duhet të përfshijë rehabilitimin e plotë të godinave dhe pavioneve në mënyrë që të kenaqë sa më shumë kërkesat për realizimin e një këtyre godinave trekatëshe (Korpusi Qendror) sa më bashkëkohore. Projektet e rikonstruksionit duhet të përfshijnë:

- a) Rikonstruksionin e katit perdhe për çdo ndërtesë dhe ambient pjesë të Bllokut 1.
- b) Rikonstruksionin e katit te parë për çdo ndërtesë dhe ambient pjesë të Bllokut 1
- c) Rikonstruksionin e katit te dytë për çdo ndërtesë dhe ambient pjesë të Bllokut 1
- d) Rikonstruksionin e tarracës duke marrë në konsideratë zgjidhjen e hidroizolimit të tyre.
- e) Instalimet elektrike, të ndriçimit, hidraulike, MNZ, data, telefoni, kamera, HVAC etj.

3.2. Kërkesa specifike

a. Rikonstruksioni i ambienteve të Bllokut 1 dhe konceptimi i tyre në mënyrë që të përmbajnë:

Ambjentet e godinave dhe të pavioneve të Bllokut 1 nuk do të ndryshojnë funksionalitetin e tyre, pra nuk do të ketë një rikonceptim të godinave, por thjesht një rikonstruksion total të tyre.



b. Punime prishjeje:

Kryesisht arkitektura do të jetë ajo egzistuese, por ka nevojë të bëhen disa ndërhyrje si prishje e suvatimeve, prishje muresh (nese do te shikohet e nevojshme per ndertime muresh te rinj etj.

Të çmontohet dhe largohet i gjithë sistemi hidraulik dhe elektrik ekzistues i degraduar dhe jashtë çdo lloj funksioni, për ta pershatur në funksion të qëllimit dhe kërkesave specifike të sipërpërmendura.

c. Ndërtime:

- Rehabilitim i pjesëve konstruktive;
- Ndërtime muresh (kur del nevoja për ndarje hapësirash), suvatimeve të reja, lyerje totale të ambjenteve, tavane të varura (kur del nevoja), hidroizolim i çative, vetrata xhami, rrjeta dhe grila dritaresh etj.
- Ndertime totale të sistemeve elektrike
- Ndertime të sistemeve mekanike

3.3. Shfrytëzimi i hapësirave nga PAK – personat me aftësi të kufizuara

Është qëllimi i këtij kapitulli dhe në çdo Detyrë Projektimi të kësaj rëndësie të sigurojë që të gjitha objektet me interesa shoqëror dhe publik të mbrojnë dhe të parashikojnë përdorimin e objekteve edhe për personat me aftësi të kufizuara lëvizëse.

3.4. Projekti Arkitektonik

Në godinat përbërëse të Bllokut 1 ka nevojë të bëhen disa ndërhyrje si prishje muresh për hapjen e hapësirave, ndërtim muresh (kur del nevoja për ndarje hapësirash), prishje e suvatimeve, bërja e suvatimeve të reja, lyerje totale të ambjenteve, etj.

“Grupi i Projektimit” duhet të bëjë zgjidhjen arkitektonike më të përshtatshme për rikonstrukcionin e ndërtesave ose pavioneve duke patur parasysh natyrën e veprimtarisë së institucioneve, skemën funksionale të tij, harmonizimin me ndërtimet përreth dhe eksperiencat me të mira dhe të përshtatshme që ekzistojnë.

3.5. Projekti Konstruktiv

Si objekte te rëndësisë së veçantë, të gjitha ndërhyrjet që parashikohen të bëhen në këto objekte duhet të marrin parasysh të gjitha kërkesat e kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit në fuqi.



Nëse shihet e domosdoshme që për rikonstruksionin e godinave të bëhen ndërhyrje konstruktive (aty ku paraqitet problematike), atëherë llogaritjet konstruktive statike e dinamike duhet të marrin parasysh të gjitha kërkesat e kushtet teknike të projektimit dhe të zbatimit.

Në llogaritjet dinamike duhet të merret koeficienti i rëndësisë 1.75 (kushti teknik sizmik KTP Nr.2-89).

Sistemi konstruktiv do të llogaritet për efekt të ngarkesave, duke marrë parasysh punën e përbashkët të strukturave vertikale e horizontale, mbështetur në punën hapësinore të konstruksionit.

3.6. Projekti elektrike

Projektet elektrike duhet të respektojnë të gjitha konditat projektuese dhe standartet që janë sot në fuqi në Shqipëri .

Ndriçimi rekomandohet të llogaritet sipas flukseve për ambientet dhe llojit të ndriçuesit. Kujdes i veçantë duhet të kushtohet ndriçimit të brendshëm.

Energjia elektrike do të rezervohet edhe nëpërmjet gjeneratoreve. Motogjeneratorët mendohet të mbulojnë deri në 75% të fuqisë së instaluar. Gjeneratorët elektrik me motor diesel do të ketë karakteristika të përgjithshme që të kenaqin normat e shfrytëzimit sikurse janë gjeneratorët trefazor 400V me fuqi sipas kalkulimeve të kërkesave, ftohje të motorit me ujë, grup silencioz të shkarkimeve të gazrave , rezervuar minimal të karburantit me galexhant si dhe rrjet tubacionesh për furnizim në mënyre të vazhdueshme me lëndë djegëse, panel të nisjes dhe komutimit automatik, sistem diagnostikimi të defekteve dhe mirëmbajtjes etj.

Fuqia e gjeneratorëve është në varësi të ngarkesës që ata do të mbajnë dhe duhen llogaritur nga inxhinieri projektues elektrik.

Në ambientet ku ka pajisje kompjuterike, elektronike të rëndësishme, pajisje sigurie dhe mbikqyrjeje, sisteme data dhe rack është e domosdoshme të përdoren furnizimi i tyre në mënyrë të garantuar dhe të pandërprerë. Këtë mënyrë furnizimi e sigurojnë pajisjet e ushqimit të pandërprerë, UPS.

3.7. Projekti Hidroteknik (furnizim me ujë dhe kanalizime)

Grupi i Projektimit duhet të marrë në konsideratë rrjetin ekzistues të ujësjellësit dhe të kanalizimeve të godinave ose pavioneve.

Rrjeti i ujësjellësit dhe ai i shkarkimit të ujrave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkëkohore dhe në përputhje me standartet në fuqi, nëse vlerësohet nga “Grupi i Projektimit” të ndërhyhet.

Duhet të parashikohet rrjeti i ujësjellësit për godinat për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës.

Materialet që do përdoren për rrjetin e ujësjellësit do të llogariten për aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

Duhet të parashikohen vendosjet e depozitave të ujit, e nevojshme në raste emergjence.

Në qoftë se do të ndodhemi para faktit të rikonstruktimit të WC-ve pa dritare, të projektohet vendosja e aspiratorëve për ndërrimin e ajrit të cilët të funksionojnë në mënyrë automatike (me role kohe apo regjim tjetër e zgjedh “Grupi i Projektimit”). Çdo pajisje të kompletohet me rubineta filtër në hyrje të ujit ngrohtë dhe atij të ftohtë. Tubat e furnizimit me ujë të jenë plastik për presion 10Atm. Ndërsa tubat e shkarkimeve të projektohen me material të cilësisë së parë dhe me gominë në zgjatim, po kështu me gominë dhe të gjitha rakorderitë. Detyrë e “Grupi të Projektimit” është të përcaktojë pikën e shkarkimit të ujërave të përdorura jashtë objekteve dhe lidhjet me rrjetin ekzistues K.U.Z.

Sigurimi i ujit te pijshëm bëhet nga rrjeti kryesor. Sistemi i furnizimit me ujë do të kryejë dy sherbime: . Për të siguruar presion të barabartë në çdo kat të ndërtesave, do të vendosen reduktorë presioni të taruar në 3 bar.

Uji teknologjik për nevojat e sistemit HVAC do të sigurohet nga pompa me motor inverter për të siguruar presion konstant.

Uji i ngrohtë sanitar do të sigurohet nga boilerë elektrikë, kapaciteti i të cilëve do të varet nga numri i aparateve hidrosanitare që do të furnizohen me ujë të ngrohtë nga çdo boiler.

3.8. Projekti i Mbrojtjes nga Zjarri (MNZ)

Impjanti i mbrojtjes nga zjarri do të jetë pjesë e impjantit MKZ të të gjithë objekteve. Ai do të përfshijë mbrojtjen e territorit si dhe të ndërtesave në brendësi. Ai do të projektohet në përputhje me normativat e sigurisë nga zjarri dhe në përputhje me normën UNI 9490 si dhe ato lokale në fuqi, sikurse ligji Nr. 8776, datë 5.4.2001, Vendimi K.M Nr.699, datë 22.10.2004”.

Në brendësi të ndërtesave, për çdo shkallë do të ketë magjistral me tub çeliku, pa tegel, me mure të trashë, si dhe hidrante në çdo katë. Uji për sistemin e zjarrit do të rezervohet për të siguruar një autonomi prej 3-6 orësh në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 722, datë 19.11.1998.

Ky sistem, është shumë i rëndësishëm për ndërtesat në tërësi dhe duhet të jetë i ndërlidhur me përmasimet strukturale/arkitektonike, me sistemin mekanik të mbrojtjes kundra zjarrit dhe evakuimin e personave.

Ata do të përzgjidhen në funksion të zgjidhjes arkitektonike, duke siguruar zbatimin e normave për mbrojtjen kundra zjarrit, në të dy rastet, në aspektin pasiv të sistemit kundra zjarrit (i lidhur me karakteristikat e ndërtesave) dhe në aspektin aktiv të sistemit kundra zjarrit (i lidhur me instalimet elektrike dhe mekanike të mbrojtjes kundra zjarrit) i cili është objekt i instalimeve mekanike.

Rrjeti i brendshëm dhe i jashtëm i tubave për furnizimin me ujë do të realizohet nga materiale të përshtatshme, të përzgjedhura me gjykimin e “Grupi të Projektimit” sipas normave dhe standarteve teknike.

Në këto ambiente duhet të vendosen (ku vlerësohet e nevojshme) sensorët e detektimit të tymit.

Rekomandojmë sensorët e tymit që kanë certifikimet UCL, UL, CSFM, MSFM, dhe MEA që plotësojnë kërkesat e EN 54.

Sensori lejon monitorimin e rregullt sipas një cikli të ndjeshmërisë së tij (jep shkallën e papastërtive).



Është e rëndësishme që këta Sensorë të vendosen mbi tavan të varur, sidomos në rrugëkalimet e kablllove të fuqisë dhe kanalëve.

Sensorët e dhënies së alarmit të Zjarrit janë të projektuar për një temperaturë fikse kufi dhe japin alarme zjarri nëse në ambientin ku janë vendosur ka lëvizje të menjëherëshme të temperaturës deri në kufirin e temperaturës së programuar.

“Grupi i Projektimit” duhet të ketë parasysh zbatimin e të gjitha normave të MKZ-së në përshtatje të ambjenteve.

3.9. Projekti i Ngrohje/ Ftohjes dhe Ventilimit

Në këto ambjente duhet të sigurohen kushtet e nevojshme për ngrohje ftohje të ambientit. Pra detyra e “Grupit të Projektimit” është të vlerësojë gjëndjen aktuale dhe të përcaktojë masat e nevojshme për të siguruar një funksion normal të këtyre të ambjenteve përshtatur me funksionin që kanë. Sugjerohet sistem ngrohje ftohje qëndrore për gjithë godinat.

Sistemi i ngrohjes/kondicionimit duhet të projektohet në përputhje me Ligji Nr. 8937, datë 12.9.2002 dhe VKM Nr. 38, datë 16.01.2003, “Për miratimin e normave të rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe të ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa” (Për respektimin e koeficientit vëllimor normativ të humbjeve tërmiqe, $Gat < Gvt, 0$).

Kriteret projektuese të impiantit HVAC për konditat e jashtme do të jënë të njëjta, ndërsa për ato të brendshme do të jënë në funksion të destinacioneve të objekteve në përputhje me standardet evropiane si dhe ato të shprehura në rregulloren e VKM Nr. 38 date 16.01.2003.

3.10. Projektin e Sistemit të Gazit Medikal

Godinat dhe pavionet e këtij blloku ndërtesash nuk kanë nevojë për sistem të mirëfilltë për gazin medikal por vetëm për bombola me gazin e nevojshëm. Për këtë qëllim do të jetë e nevojshme që grupi i projektimit të llogarisë dhe të marrë masa për vendosjen e këtyre bombolave në vendet më të përshtatshme.

3.11. Projektin e Sistemit të Kamerave

Në ambjentet e lartpërmendura mungon komplet ose është i limituar sistemi i monitorimit me kamera. Duhet llogaritur zhvendosja e atyre ekzistuese (nese ka) dhe gjithashtu të bëhet vendosja e sistemit të monitorimit të kamerave në të gjithë ambjentet që shihet e nevojshme.

3.12. Sistemi CCTV dhe ACCES CONTROL

Sistemi i vëzhgimit me kamera si një element i rëndësishëm për sigurinë e objekteve të ekspozuara



dhe të gjithë objekteve në tërësi. Ai duhet të sigurojë jo vetëm cilësinë në shërbimin që ofron, por edhe vazhdimësinë dhe sigurinë në punë. Kjo cilësi realizohet nëpërmjet “Integrated Camera System”, ku të gjitha kamerat të jenë dixhitale dhe të adresueshme.

Sistemin survejimit do të ketë kamera e monitore me ngjyra, instalimin e kamerave të tipeve të ndryshëm e me komandim. Videoregjistratori do të jetë digital me hard disk me mundësi lidhje në rrjet LAN4 me cilësi dhe kapacitet të lartë regjistrimi, ruajtje të tij dhe me kërkim të pamjeve sipas orës, datës, etj. Ato do të vendosen në hyrje të ndërtesave dhe brenda tyre.

Rrjetet internet, citofoni

(Kontrolli i rrjetit të internetit ose zëvendësimi sipas rastit). Rrjeti internetit do të realizohet me tela dhe kuti në mënyrë që të krijojë një komunikim nga burimi i linjës dhe dhomave të aparaturave qendrore dhe më pas në të gjithë ndërtesat. Citofonia gjithashtu është shumë e nevojshme për të realizuar komunikimin e personelit të spitalit në këto pavione dhe ndërtesa.

03

QËLLIMI I PROJEKTIMIT (BLLOKU II)

Të përgjithshme - Përshkrimi i objekteve ekzistuese

Blloku 2 (trekatëshe)

- 1- Kirurgji II
- 2- Reanimacioni

Korpusi Qëndror i “Spitalit Universitar të Traumës”, të ndodhur në Rrugën “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë, ka filluar të shfrytëzohet në vitet 1930. Aktualisht ambientet shfrytëzohen dhe janë në funksionim normal për pacientët si dhe për personelin e shërbimit.

Gjendja e përgjithshme e objekteve, shfaqet e rënduar dhe e amortizuar në kohë. Në muret perimetrale, xokolaturat e betonit deri tek brezat ku fillojnë muraturat, kanë prezencë të vazhdueshme të lagështisë në to.

3.13. Kërkesa të përgjithshme

Projekti i rikonstruksionit duhet të përfshijë rehabilitimin e plotë të godinave dhe pavioneve në mënyrë që të kenaqë sa më shumë kërkesat për realizimin e një këtyre godinave trekatëshe



(Korpusi Qendror) sa më bashkëkohore. Projektet e rikonstruksionit duhet të përfshijnë:

- f) Rikonstruksionin e katit perdhe për çdo ndërtesë dhe ambient pjesë të Bllokut 2.
- g) Rikonstruksionin e katit te parë për çdo ndërtesë dhe ambient pjesë të Bllokut 2
- h) Rikonstruksionin e katit te dytë për çdo ndërtesë dhe ambient pjesë të Bllokut 2
- i) Rikonstruksionin e tarracës duke marrë në konsideratë zgjidhjen e hidroizolimit të tyre.
- j) Instalimet elektrike, të ndriçimit, hidraulike, MNZ, data, telefoni, kamera, HVAC etj.

3.14. Kërkesa specifike

d. Rikonstruksioni i ambienteve të Bllokut 1 dhe konceptimi i tyre në mënyrë që të përmbajnë:

Ambjentet e godinave dhe të pavioneve të Bllokut 2 nuk do të ndryshojnë funksionalitetin e tyre, pra nuk do të ketë një rikonceptim të godinave, por thjesht një rikonstruksion total të tyre.

e. Punime prishjeje:

Kryesisht arkitektura do të jetë ajo egzistuese, por ka nevojë të bëhen disa ndërhyrje si prishje e suvatimeve, prishje muresh (nese do te shikohet e nevojshme per ndertime muresh te rinj etj.

Të çmontohet dhe largohet i gjithë sistemi hidraulik dhe elektrik ekzistues i degraduar dhe jashtë çdo lloj funksioni, për ta pershatur në funksion të qëllimit dhe kërkesave specifike të sipërpërmendura.

f. Ndërtime:

- Rehabilitim i pjesëve konstruktive;
- Ndërtime muresh (kur del nevoja për ndarje hapësirash), suvatimeve të reja, lyerje totale të ambienteve, tavane të varura (kur del nevoja), hidroizolim i çatave, vetrata xhami (nëse kërkohet për ndarjen midis shtretërve të pacientëve në reanimacion), rrjeta dhe grila dritaresh etj.
- Ndërtime totale të sistemeve elektrike
- Ndërtime të sistemeve mekanike

3.15. Shfrytëzimi i hapësirave nga PAK – personat me aftësi të kufizuara

Është qëllimi i këtij kapitulli dhe në çdo Detyrë Projektimi të kësaj rëndësie të sigurojë që të gjitha objektet me interesa shoqëror dhe publik të mbrojnë dhe të parashikojnë përdorimin e objekteve



edhe për personat me aftësi të kufizuara lëvizëse.

3.16. Projekti Arkitektonik

Në godinat përbërëse të Bllokut 2 ka nevojë të bëhen disa ndërhyrje si prishjen dhe ndërtime muresh (kur del nevoja për ndarje hapësirash), prishje e suvatimeve, bërja e suvatimeve të reja, lysterje totale të ambjenteve, etj.

“Grupi i Projektimit” duhet të bëjë zgjidhjen arkitektonike më të përshtatshme për rikonstrukcionin e ndërtesave ose pavioneve duke patur parasysh natyrën e veprimtarisë së institucioneve, skemën funksionale të tij, harmonizimin me ndërtimet përreth dhe eksperiencat me të mira dhe të përshtatshme që ekzistojnë.

3.17. Projekti Konstruktiv

Si objekte të rëndësishme të veçantë, të gjitha ndërhyrjet që parashikohen të bëhen në këto objekte duhet të marrin parasysh të gjitha kërkesat e kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit në fuqi. Nëse shihet e domosdoshme që për rikonstrukcionin e godinave të bëhen ndërhyrje konstruktive (aty ku paraqitet problematike), atëherë llogaritjet konstruktive statike e dinamike duhet të marrin parasysh të gjitha kërkesat e kushtet teknike të projektimit dhe të zbatimit.

Në llogaritjet dinamike duhet të merret koeficienti i rëndësishëm 1.75 (kushti teknik sizmik KTP Nr.2-89).

Sistemi konstruktiv do të llogaritet për efekt të ngarkesave, duke marrë parasysh punën e përbashkët të strukturave vertikale e horizontale, mbështetur në punën hapësinore të konstruksionit.

3.18. Projekti elektrike

Projektet elektrike duhet të respektojnë të gjitha konditat projektuese dhe standartet që janë sot në fuqi në Shqipëri .

Ndriçimi rekomandohet të llogaritet sipas flukseve për ambientet dhe llojit të ndriçuesit. Kujdes i veçantë duhet të kushtohet ndriçimit të brendshëm.

Energjia elektrike do të rezervohet edhe nëpërmjet gjeneratoreve. Në ambientet ku ka pajisje kompjuterike, elektronike të rëndësishme, pajisje sigurie dhe mbikqyrjeje, sisteme data dhe rack është e domosdoshme të përdoren furnizimi i tyre në mënyrë të garantuar dhe të pandërprerë. Këtë mënyrë furnizimi e sigurojnë pajisjet e ushqimit të pandërprerë, UPS.

3.19. Projekti Hidroteknik (furnizim me ujë dhe kanalizime)

Grupi i Projektimit duhet të marrë në konsideratë rrjetin ekzistues të ujësjellësit dhe të kanalizimeve të godinave ose pavioneve.

Rrjeti i ujësjellësit dhe ai i shkarkimit të ujrave të zeza do të ndërtohet me materiale bashkëkohore



dhe në përputhje me standartet në fuqi, nëse vlerësohet nga “Grupi i Projektimit” të ndërhyhet.

Duhet të parashikohet rrjeti i ujësjellësit për godinat për furnizim me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje gjatë ditës.

Materialet që do përdoren për rrjetin e ujësjellësit do të llogariten për aftësi mbajtëse në përputhje me prurjet dhe presionet llogaritëse.

Duhet të parashikohen vendosjet e depozitave të ujit, e nevojshme në raste emergjence.

Në qoftë se do të ndodhemi para faktit të rikonstruktimit të WC-ve pa dritare, të projektohet vendosja e aspiratorëve për ndërrimin e ajrit të cilët të funksionojnë në mënyrë automatike (me role kohe apo regjim tjetër e zgjedh “Grupi i Projektimit”). Çdo pajisje të kompletohet me rubineta filtër në hyrje të ujit ngrohtë dhe atij të ftohtë. Tubat e furnizimit me ujë të jenë plastik për presion 10Atm. Ndërsa tubat e shkarkimeve të projektohen me material të cilësisë së parë dhe me gominë në zgjatim, po kështu me gominë dhe të gjitha rakorderitë. Detyrë e “Grupi të Projektimit” është të përcaktojë pikën e shkarkimit të ujërave të përdorura jashtë objekteve dhe lidhjet me rrjetin ekzistues K.U.Z.

Sigurimi i ujit të pijshëm bëhet nga rrjeti kryesor. Sistemi i furnizimit me ujë do të kryejë dy sherbime: Për të siguruar presion të barabartë në çdo kat të ndërtesave, do të vendosen reduktorë presioni të taruar në 3 bar.

Uji teknologjik për nevojat e sistemit HVAC do të sigurohet nga pompa me motor inverter për të siguruar presion konstant.

Uji i ngrohtë sanitar do të sigurohet nga boilerë elektrikë, kapaciteti i të cilëve do të varet nga numri i aparateve hidrosanitare që do të furnizohen me ujë të ngrohtë nga çdo boiler.

3.20. Projekti i Mbrojtjes nga Zjarri (MNZ)

Impjanti i mbrojtjes nga zjarri do të jetë pjesë e impjantit MKZ të të gjithë objekteve. Ai do të përfshijë mbrojtjen e territorit si dhe të ndërtesave në brendësi. Ai do të projektohet në përputhje me normativat e sigurisë nga zjarri dhe në përputhje me normën UNI 9490 si dhe ato lokale në fuqi, sikurse ligji Nr. 8776, datë 5.4.2001, Vendimi K.M Nr.699, datë 22.10.2004”.

Në brendësi të ndërtesave, për çdo shkallë do të ketë magjistral me tub çeliku, pa tegel, me mure të trashë, si dhe hidrante në çdo katë. Uji për sistemin e zjarrit do të rezervohet për të siguruar një autonomi prej 3-6 orësh në përputhje me përcaktimet e VKM Nr. 722, datë 19.11.1998.

Ky sistem, është shumë i rëndësishëm për ndërtesat në tërësi dhe duhet të jetë i ndërlidhur me përmasimet strukturale/arkitektonike, me sistemin mekanik të mbrojtjes kundra zjarrit dhe evakuimin e personave.

Ata do të përzgjidhen në funksion të zgjidhjes arkitektonike, duke siguruar zbatimin e normave për mbrojtjen kundra zjarrit, në të dy rastet, në aspektin pasiv të sistemit kundra zjarrit (i lidhur me karakteristikat e ndërtesave) dhe në aspektin aktiv të sistemit kundra zjarrit (i lidhur me instalimet elektrike dhe mekanike të mbrojtjes kundra zjarrit) i cili është objekt i instalimeve mekanike.

Rrjeti i brendshëm dhe i jashtëm i tubave për furnizimin me ujë do të realizohet nga materiale të përshtatshme, të përzgjedhura me gjykimin e “Grupi të Projektimit” sipas normave dhe standarteve



teknike.

Në këto ambiente duhet të vendosen (ku vlerësohet e nevojshme) sensorët e detektimit të tymit.

Rekomandojmë sensorët e tymit që kanë certifikimet UCL, UL, CSFM, MSFM, dhe MEA që plotësojnë kërkesat e EN 54.

Sensori lejon monitorimin e rregullt sipas një cikli të ndjeshmërisë së tij (jep shkallën e papastërtive).

Është e rëndësishme që këta Sensorë të vendosen mbi tavan të varur, sidomos në rrugëkalimet e kablllove të fuqisë dhe kanalëve.

Sensorët e dhënies së alarmit të Zjarrit janë të projektuar për një temperaturë fikse kufi dhe japin alarme zjarri nëse në ambientin ku janë vendosur ka lëvizje të menjëherëshme të temperaturës deri në kufirin e temperaturës së programuar.

“Grupi i Projektimit” duhet të ketë parasysh zbatimin e të gjitha normave të MKZ-së në përshtatje të ambjenteve.

3.21. Projekti i Ngrohje/ Ftohjes dhe Ventilimit

Në këto ambiente duhet të sigurohen kushtet e nevojshme për ngrohje ftohje të ambientit. Pra detyra e “Grupit të Projektimit” është të vlerësojë gjëndjen aktuale dhe të përcaktojë masat e nevojshme për të siguruar një funksion normal të këtyre të ambjenteve përshtatur me funksionin që kanë. Sugjerohet sistem ngrohje ftohje qëndrore për gjithë godinat.

Sistemi i ngrohjes/kondicionimit duhet të projektohet në përputhje me Ligji Nr. 8937, datë 12.9.2002 dhe VKM Nr. 38, datë 16.01.2003, “Për miratimin e normave të rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe të ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa” (Për respektimin e koeficientit vëllimor normativ të humbjeve tërmiqe, $Gat < Gvt, 0$).

Kritereret projektuese të impiantit HVAC për konditat e jashtme do të jenë të njëjta, ndërsa për ato të brendshme do të jenë në funksion të destinacioneve të objekteve në përputhje me standardet evropiane si dhe ato të shprehura në rregulloren e VKM Nr. 38 datë 16.01.2003.

3.22. Projektin e Sistemit të Gazit Medikal

Në Godinat ose pavionin (reanimacioni), në të cilin ka nevojë për gaz medikal do të projektohet impiantati i gazeve medikale (mjeksore) për këtë duhet të parashikohet gaz oksigjeni dhe vakumi. Lidhja e sistemit të ri duhet të parashikohet që të lidhet me linjën ekzistuese të spitalit. Është e nevojshme që të ketë panel kontrolli si dhe atë të reduktimit.

Sistemi shpërndarës duhet të parashikohet me tuba bakri për përdorim mjeksor sipas standarteve evropianeve mbi projektimin e godinave spitalore.(EN 13348).

Godina dhe pavioni tjetër i këtij blloku ndërtesash nuk kanë nevojë për sistem të mirëfilltë për gazin medikal por vetëm për bombola me gazin e nevojshëm. Për këtë qëllim do të jetë e nevojshme që grupi i projektimit të llogarisë dhe të marrë masa për vendosjen e këtyre bombolave në vendet më të



përshtatshme.

3.23. Projektin e Sistemit të Kamerave

Në ambjentet e lartpërmendura mungon komplet ose është i limituar sistemi i monitorimit me kamera. Duhet llogaritur zhvendosja e atyre ekzistuese (nese ka) dhe gjithashtu të bëhet vendosja e sistemit të monitorimit të kamerave në të gjithë ambjentet që shihet e nevojshme.

3.24. Sistemi CCTV dhe ACCES CONTROL

Sistemi i vëzhgimit me kamera si një element i rëndësishëm për sigurinë e objekteve të ekspozuara dhe të gjithë objekteve në tërësi. Ai duhet të sigurojë jo vetëm cilësinë në shërbimin që ofron, por edhe vazhdimësinë dhe sigurinë në punë. Kjo cilësi realizohet nëpërmjet “Integrated Camera System”, ku të gjitha kamerat të jenë dixhitale dhe të adresueshme.

Sistemin survejimit do të ketë kamera e monitore me ngjyra, instalimin e kamerave të tipeve të ndryshëm e me komandim. Videoregjistratori do të jetë digital me hard disk me mundësi lidhje në rrjet LAN4 me cilësi dhe kapacitet të lartë regjistrimi, ruajtje të tij dhe me kërkim të pamjeve sipas orës, datës, etj. Ato do të vendosen në hyrje të ndërtesave dhe brenda tyre.

Rrjetet internet, citofoni

(Kontrolli i rrjetit të internetit ose zëvendësimi sipas rastit). Rrjeti internetit do të realizohet me tela dhe kuti në mënyrë që të krijojë një komunikim nga burimi i linjës dhe dhomave të aparaturave qendrore dhe më pas në të gjithë ndërtesat. Citofonia gjithashtu është shumë e nevojshme për të realizuar komunikimin e personelit të spitalit në këto pavione dhe ndërtesa.

03

QËLLIMI I PROJEKTIMIT (BLLOKU III)

Të përgjithshme - Përshkrimi i objekteve ekzistuese

Blloku 3 (dykatëshe + 1 kat nëntokë)

- 1- Urgjenca dhe Sallat e Urgjences (kati I përdhe)
- 2- Blloku Operator (kati I parë)
- 3- Imazheria (kati nëntokë)

Korpusi Qëndror i “Spitalit Universitar të Traumës”, të ndodhur në Rrugën “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë, ka filluar të shfrytëzohet në vitet 1930. Aktualisht ambientet shfrytëzohen dhe janë në funksionim normal për pacientët si dhe për personelin e shërbimit.

Gjendja e përgjithshme e objekteve, shfaqet e rënduar dhe e amortizuar në kohë. Në muret perimetrale, xokolaturat e betonit deri tek brezat ku fillojnë muraturat, kanë prezencë të vazhdueshme të lagështisë në to.

3.25. Kërkesa të përgjithshme

Projekti i rikonstruksionit duhet të përfshijë rehabilitimin e plotë të godinave dhe pavioneve në menyrë që të kenaqë sa më shumë kërkesat për realizimin e një këtyre godinave trekatëshe (Korpusi Qendror) sa më bashkëkohore. Projektet e rikonstruksionit duhet të përfshijnë:

- k) Rikonstruksionin e katit perdhe për çdo ndërtesë dhe ambient pjesë të Bllokut 3.
- l) Rikonstruksionin e katit te parë për çdo ndërtesë dhe ambient pjesë të Bllokut 3
- m) Rikonstruksionin e katit nentokë për çdo ndërtesë dhe ambient pjesë të Bllokut 3
- n) Rikonstruksionin e tarracës duke marrë në konsideratë zgjidhjen e hidroizolimit të tyre.
- o) Instalimet elektrike, të ndriçimit, hidraulike, MNZ, data, telefoni, kamera, HVAC etj.

3.26. Kërkesa specifike

g. Rikonstruksioni i ambienteve të Bllokut 1 dhe konceptimi i tyre në mënyrë që të përmbajnë:

Ambjentet e godinave dhe të pavioneve të Bllokut 3 nuk do të ndryshojnë funksionalitetin e tyre, pra nuk do të ketë një rikonceptim të godinave, por thjesht një rikonstruksion total të tyre.

h. Punime prishjeje:

Kryesisht arkitektura do të jetë ajo egzistuese, por ka nevojë të bëhen disa ndërhyrje si prishje e sivatimeve, kontroll persa i perket pjeses se lageshtires, prishje muresh (nese do te shikohet e nevojshme per ndertime muresh te rinj etj.

Të çmontohet dhe largohet i gjithë sistemi hidraulik dhe elektrik ekzistues i degraduar dhe jashtë çdo lloj funksioni, për ta pershatur në funksion të qëllimit dhe kërkesave specifike të sipërpërmendura.



i. Ndërtime:

- Rehabilitim i pjesëve konstruktive;
- Ndërtime muresh (kur del nevoja për ndarje hapësirash), suvatimeve të reja, lyerje totale të ambjenteve, tavane të varura (kur del nevoja), hidroizolim i çative, vetrata xhami, rrjeta dhe grila dritarësh, të shqyrtohet veshja e mureve me materiale të padepërtueshme ndaj rrezeve në imazheri, të shqyrtohet vendosja e xhamave të paderpërtueshem ndaj rrezeve etj.
- Ndërtime totale të sistemeve elektrike
- Ndërtime të sistemeve mekanike

3.27. Shfrytëzimi i hapësirave nga PAK – personat me aftësi të kufizuara

Është qëllimi i këtij kapitulli dhe në çdo Detyrë Projektimi të kësaj rëndësie të sigurojë që të gjitha objektet me interesa shoqëror dhe publik të mbrojnë dhe të parashikojnë përdorimin e objekteve edhe për personat me aftësi të kufizuara lëvizëse.

3.28. Projekti Arkitektonik

Në godinat përbërëse të Bllokut 3 ka nevojë të bëhen disa ndërhyrje si prishje dhe ndërtime muresh (kur del nevoja për ndarje hapësirash), prishje e suvatimeve, bërja e suvatimeve të reja, lyerje totale të ambjenteve, etj.

“Grupi i Projektimit” duhet të bëjë zgjidhjen arkitektonike më të përshtatshme për rikonstruksionin e ndërtesave ose pavioneve duke patur parasysh natyrën e veprimtarisë së institucioneve, skemën funksionale të tij, harmonizimin me ndërtimet përreth dhe eksperiencat me të mira dhe të përshtatshme që ekzistojnë.

3.29. Projekti Konstruktiv

Si objekte të rëndësisë së veçantë, të gjitha ndërhyrjet që parashikohen të bëhen në këto objekte duhet të marrin parasysh të gjitha kërkesat e kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit në fuqi. Nëse shihet e domosdoshme që për rikonstruksionin e godinave të bëhen ndërhyrje konstruktive (aty ku paraqitet problematike), atëherë llogaritjet konstruktive statike e dinamike duhet të marrin parasysh të gjitha kërkesat e kushtet teknike të projektimit dhe të zbatimit.

Në llogaritjet dinamike duhet të merret koeficienti i rëndësisë 1.75 (kushti teknik sizmik KTP Nr.2-89).

Sistemi konstruktiv do të llogaritet për efekt të ngarkesave, duke marrë parasysh punën e përbashkët të strukturave vertikale e horizontale, mbështetur në punën hapësinore të rikonstruksionit.

3.30. Projekti elektrike

Projektet elektrike duhet të respektojnë të gjitha konditat projektuese dhe standartet që janë sot në fuqi në Shqipëri.

Ndriçimi rekomandohet të llogaritet sipas flukseve për ambientet dhe llojit të ndriçuesit. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet ndriçimit të brendshëm.

Energjia elektrike do të rezervohet edhe nëpërmjet gjeneratoreve. Në ambientet ku ka pajisje kompjuterike, elektronike të rëndësishme, pajisje sigurie dhe mbikqyrjeje, sisteme data dhe rack është e domosdoshme të përdoren furnizimi i tyre në mënyrë të garantuar dhe të pandërprerë. Këtë mënyrë furnizimi e sigurojnë pajisjet e ushqimit të pandërprerë, UPS.

3.31. Projekti Hidroteknik (furnizim me ujë dhe kanalizime)

Grupi i Projektimit duhet të marrë në konsideratë rrjetin ekzistues të ujësjellësit dhe të kanalizimeve të godinave ose pavioneve.

